



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.07.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së datave 19.06.2018, 20.06.2018, 21.06.2018.
2. Miratimi i kalendarit 3-javor të punës së komisionit.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Luan Harusha, Elona Hoxha, Anduel Xhindi, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Klodjana Spahiu

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Myslym Murrizi, Paulin Sterkaj, Ervin Saliangji, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunksi, Isuf Çelaj.

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Renata Balliu – përfaqësuese nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Ernest Dimashi – përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Ylli Kumria – përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Zyhdi Mema – përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Ejona Hoxha - përgjegjëse sektori në Drejtorinë e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Shpresa Shahaj - specialiste në Drejtorinë e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Hapim mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Në mbledhjen e sotme të komisionit, kemi planifikuar:

- Miratimin e procesverbaleve të mbledhjes së datave 19.06.2018, 20.06.2018 dhe 21.06.2018. Këto mbledhje i kemi zhvilluar për shqyrtimin e ligjit për masat kundër dhunës në familje.

- Miratimin e kalendarit 3-javor të punës së komisionit. Sekretarja e komisionit ju ka shpërndarë një draftkalendar paraprakisht të gjithëve. Dëshiroj t'ju bëj me dije se kalendari është i ngarkuar, kështu që në javët pasardhëse deri të mërkurën, Komisioni i Sigurisë do të ketë pothuajse çdo ditë mbledhje.

- Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”.

- Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

Të ftuar për të bërë prezantimin e këtyre dy projektligjeve janë të pranishme: zonja Roven Voda, zëvendësministre; zonja Renata Balliu, nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, të cilave u uroj mirëseardhjen në komision.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kanë ardhur zotërinjtë: Ernest Dimashi, Ylli Kumria dhe Zyhdi Mema.

Po ashtu, janë të pranishme zonja Ejona Hoxha, përgjegjëse sektori nga Drejtoria e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane, në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, si dhe zonja Shpresa Shahaj, specialiste në këtë drejtori.

Ju falënderoj për prezencën!

Relator për të 2 projektligjet është zoti Xhemal Qefalia.

Jeni dakord me pikën e parë të rendit të ditës?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Jeni dakord me pikën e dytë të rendit të ditës?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Faleminderit!

Fillojmë prezantimin e marrëveshjes së parë. I jap fjalën zëvendësministres, Rovenë Voda për të na bërë një prezantim të përmblodhur. Meqenëse bëhet fjalë për dy marrëveshje ndërkombëtare, kuptohet se ne nuk do të ndërhyjmë në tekstin e marrëveshjeve.

Më pas fjalën e ka relatori.

Faleminderit!

Rovena Voda – Faleminderit, kryetare e komisionit!

Nëse do të flasim për projektligjin e parë, për marrëveshjen (PISCES), sigurisht kjo marrëveshje ka për qëllim ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES). Ky sistem do të instalohet dhe do të mirëmbahet me suportin e qeverisë së SHBA-së, do të instalohet në pikat kufitare sipas marrëveshjeve të përbashkëta të dy vendeve dhe sigurisht, qëllimi është një vlerë e shtuar për sigurinë në kontrollin kufitar në të gjitha pikat kufitare të RSH-së.

Në fakt vlera e investimit është shumë e lartë, shkon mbi 5 milionë dollarë. Edhe mirëmbajtja është siguruar nga qeveria e SHBA-së. Mendoj se është një vlerë e shtuar, sepse menaxhimi i sigurimit të kufijve jo vetëm që është një nga prioritetet e Ministrisë së Brendshme, por edhe të Policisë së Shtetit.

Referuar edhe detyrimeve që ne kemi në kuadër të Kapitullit 4, “Drejtësia, liria dhe siguria” në kuadër të procesit të integrimit europian. Njëkohësisht, duke pasur parasysh që edhe lufta kundër terrorizmit është një nga sfidat jo vetëm të Shqipërisë, por edhe të Europës në përgjithësi.

Nëse do të kaloja në mënyrë të përmblodhur në marrëveshjen e dytë, kjo marrëveshje apo më saktë, ky protokoll ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, vjen si pasojë e një marrëveshjeje të madhe kuadër, që ne kemi pasur me BE-në të miratuar shumë vite më parë për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar në vendet e BE-së. Marrëveshje

të tilla të ngjashme kemi pothuajse me të gjitha vendet e BE-së. Spanja ishte ndër ato pak vende, që kishte mbetur në listën e vendeve pa e bërë këtë marrëveshje.

Sigurisht, kjo marrëveshje është një vlerë e shtuar në luftën kundër migracionit të paligjshëm. Siç e dimë ky është një fenomen, i cili ka prekur jo vetëm Shqipërinë, vendet e Ballkanit Perëndimor, por edhe Europën. Kështu që, është një vlerë e shtuar në rritjen e sigurisë apo edhe në rregullimin dhe menaxhimin e këtij fenomeni. Nëpërmjet këtij protokolli të dyja palët marrin në një farë mënyre, pra kanë detyrime reciproke, ndërmjet njëra tjetrës, caktojnë pikat e kontaktit dhe modalitetet e ripranimit të këtyre personave. Mendoj se është një vlerë e shtuar në menaxhimin e fenomenit të migracionit të paligjshëm.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Qefalia!

Xhemal Qefalia - Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, unë nuk kam asgjë çfarë të shtoj më shumë, pasi këto janë marrëveshje standard. Gjëja që dua të evidentoj është marrëveshja me SHBA-në, e cila rrit në mënyrë të dukshme sigurinë në pikat kufitare.

Ajo që duhet theksuar edhe për opinionin publik, është se kjo marrëveshje do të fillojë implementimin menjëherë në Rinas dhe më pas, do të shtrihet gradualisht edhe në pikat e tjera kufitare. Kjo marrëveshje do të ndikojë bindshëm jo vetëm në rritjen e sigurisë kombëtare, por edhe në luftën që po bëhet ndaj terrorizmit.

E veçanta në këtë marrëveshje është se qeveria amerikane e ka nënshkruar disa muaj më parë dhe tani pritet vetëm nënshkrimi nga pala shqiptare.

Më vjen keq që opozita nuk është e pranishme, pasi vazhdimisht ajo është kritike ndaj qeverisë për sigurinë kombëtare në pikat kufitare. Do të ishte mirë që prezenca e tyre të ishte e qenësishme. Sidoqoftë, ajo e ka mendjen te Teatri dhe ndoshta teatri i tyre ka përfunduar, por kjo marrëveshje ka më shumë interes kombëtar sesa interes të partive politike.

Nuk kam gjë tjetër çfarë të them.

Edhe marrëveshja e dytë është një marrëveshje standarde në kuadër të marrëveshjeve të tjera të lidhura me vendet e rajonit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia!

Kalojmë te pyetjet e kolegëve për të dyja marrëveshjet.

Fjalën e ka zoti Sina!

Më pas e ka fjalën zonja Gjebrea!

Vullnet Sinaj – Në lidhje me marrëveshjen e parë me qeverinë amerikane, ju thatë se të gjitha pajisjet do t'i sjellë qeveria amerikane dhe po ajo do t'i instalojë. Besoj se kjo do të shoqërohet me numër punonjësish, i cili besoj se do të shtohet. Kam lexuar se ata do specializohen. Tani doja të dija a ka kosto të shtuara nga ana qeverisë sonë dhe a e kanë parashikuar në buxhetin, që kemi miratuar?

Ejona Hoxha - Faleminderit për pyetjen!

Në fakt nuk ka kosto të shtuara dhe unë do të shpjegoj, se përse nuk ka kosto dhe përse nuk ka nevojë për numër të shtuar punonjësish. Plus kësaj, ne ecim me një buxhet afatmesëm, pra e dimë. Edhe qeveria e di kur bën llogaritjen, buxhetin vjetor, por edhe buxhetin afatmesëm. Gjithçka është e mbuluar nga qeveria amerikane. Edhe trajnimet e policisë kufitare do të jenë të mbuluara nga ata. Do të jenë po ata punonjës që bëjnë kontrollin në vijën e parë në pikat kufitare, të cilët do të bëjnë të njëjtin verifikim, sepse zakonisht do të jenë pajisje që ndoshta mund të përdoren në vijën e dytë të kontrollit, pra për rastet, kur realisht çmohet se mund të ketë rrezikshmëri. Pra, do të jenë po të njëjtët punonjës. Kështu që, nuk do të ketë numër të shtuar dhe ndikim në buxhetin e shtetit.

Ermonela Felaj – Po, teknologjia e zvogëlon numrin e njerëzve.

Fjalën e ka zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea - Faleminderit, zonja kryetare!

Duke falënderuar zonjën zëvendësministre dhe stafin e ministrisë për prezantimin e dy projektligjeve, kam 2 pyetje për secilën prej marrëveshjeve.

Pyetja e parë, ka të bëjë me ripranimin e personave me qëndrim të paaautorizuar në vendet e BE-së, e cila, siç shkruhet në marrëveshje, është nënshkruar që në vitin 2005 dhe, ndërkohë, ne do të ndihmojmë me anë të kësaj procedure kthimin tranzit të këtyre personave. Sa është numri i këtyre personave dhe a ka ndonjë problematikë, ndonjë veçori në lidhje me këta persona, të cilët janë evidentuar në territorin e Shqipërisë që nga momenti që është nënshkruar kjo marrëveshje, apo të paktën, vitet e fundit?

Pyetja e dytë, ka të bëjë me marrëveshjen e parë. Meqenëse ky sistem, i cili ia vlen të vlerësohet, edhe kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për

krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal, ju thoni se do të fillojë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës. Deri në çfarë afati kohor keni parashikuar që ky sistem të instalohet, edhe në pikat e tjera kufitare? A keni një plan për këtë? Si është ky plan, të paktën në vija të përgjithshme?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zonja Voda!

Rovena Voda – Faleminderit, zonja Gjebrea për pyetjen!

Për sa i përket pyetjes së parë, po, është e vërtetë që marrëveshja me BE-në është nënshkruar që në maj të vitit 2006. Marrëveshja me Spanjën është në vazhden e marrëveshjeve dhe Spanja është nga vendet e fundit të BE-së dhe të atyre të zonës Shengen me të cilët ne kemi nënshkruar këtë protokoll të detajuar bashkëpunimi, pavarësisht se është standard.

Për sa i takon numrit të personave, ndoshta jo pa qëllim Spanja ka mbetur në vendet e fundit, sepse nuk është se me Spanjën në drejtim të komunikimit të dy policive respektive kufitare dhe të migracionit, kemi pasur ndonjë fluks shumë të madh të ripranimin të personave me qëndrim të paautorizuar, por gjithsesi mbetet një vlerë e shtuar në kuadër të fenomenit të migracionit të paligjshëm, trendet e të cilit mbeten një pikëpyetje.

Pse jo, ne jemi të përgatitur edhe me Spanjën në rastin konkret, për ta rregulluar, menaxhuar këtë problem. Numrat nuk janë realisht të lartë, pra nuk është ky shkak që na detyron ta nënshkruanim këtë marrëveshje me Spanjën. Thjesht, është një lloj procedure një lloj standardi që kemi ndjekur me të gjitha vendet e BE-së.

Për pyetjen tjetër, është e vërtetë, që ne kemi vendosur që implementimi i këtyre pajisjeve të fillojë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës. Sigurisht, ajo është pika më nevralgjike e kontrollit kufitar në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe i vetmi aeroport ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë, ku kërkohet një siguri maksimale.

Për sa i përket shtrirjes në pikat e tjera kufitare, marrëveshja është një memorandum qëllimi, pavarësisht se ne kemi shprehur dhe kemi shpjeguar, që do të fillojë me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës. Do të ketë një marrëveshje tjetër teknike ndërmjet të dyja palëve, ku do të ketë një plan të qartë, si do të vijojë në pikat e tjera kufitare instalimi i këtyre pajisjeve. Kështu, ndoshta është pak herët që unë të jap një përgjigje se si do të jetë kalendari i kësaj më pas. Pra, do të ketë një marrëveshje tjetër teknike në nivel ekspertësh, të cilët do të vendosin për këtë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Kolegët e tjerë a kanë pyetje? Më lejoni dhe mua të bëj dy pyetje, nga një për secilën nga marrëveshjet. Një pyetje e ezauroi edhe zonja Gjebrea, por gjithsesi, desha të dija se kur fillon nga funksionimi sistemi (PISCES)? Shuma 5 milionë dollarë që ju referuat për implementimin e këtij sistemi është vetëm për Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, apo është për të gjitha pikat e kalimit kufitar që kemi?

Kush do të jetë administratori i të dhënave, sepse bëhet fjalë për të dhëna personale? Kush do ta administrojë këtë bazë të dhënash? Këto pyetje ishin për marrëveshjen e parë.

Pyetja për marrëveshjen e dytë: ju thatë se kjo marrëveshje, të cilën ju e keni lidhur me vendet e BE-së. Mund të na tregoni një bilanc edhe me sa vende të tjera të BE-së nuk kemi lidhur ende një marrëveshje të ngjashme? Çfarë presim mbas hyrjes në fuqi të marrëveshjes në fjalë?

Rovena Voda – Faleminderit zonja kryetare për pyetjen!

Me lejen tuaj do të doja që pyetjen e parë t'ia kaloja drejtorit tonë të IT-së në Policinë e Shtetit, zotit Dimashi, meqenëse ai ka kontakte edhe me ekspertët amerikanë, për të dhënë një përgjigje më të saktë për ju.

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zoti Dimashi!

Ernest Dimashi – Faleminderit!

Në lidhje me sistemin (PISCES), siç e tha edhe zëvendësministrja, është një memorandum qëllimi, i cili është filluar me ngritjen e grupeve të punës nga institucioni ynë dhe nga pjesa e PISCES, të cilët janë duke punuar për të detajuar të gjithë planin e punës, që fillon me radhën e pikave, në të cilat do të instalohet sistemi deri në detaje, sepse njëra nga çështjet kryesore është se Shqipëria sot ka sisteme, pra nuk është se jemi në hapin e parë, që po na vjen një sistem. Ne kemi sisteme ekzistuese. Qëllimi kryesor është të integrohet ky sistem i ri që po vjen, të përpunojë të gjithë informacionin aktual që e kemi deri sot dhe normalisht, duhet të ndërveprojë edhe me sistemet e tjera, duke përfshirë që nga sistemi i gjurmëve të gishtave, pra *database-n* kriminale të gjurmëve të gishtave, menaxhimin e çështjes, sistemin TIMS. Pra, kjo është detyra kryesore e grupit të punës. Për shkak se ky është proces në vazhdim, nga pjesa amerikane akoma nuk kemi një datë të saktë, se kur do të fillojë instalimi. Na është bërë e ditur se në momentin që do të fillojë instalimi, procesi ka për të vazhduar shumë shpejt, pra për 2-3 muaj do të mbarojë instalimi në 8 pikat e para kufitare, pra janë përcaktuar 8 pika kufitare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për 3 muaj nga momenti i fillimit të instalimit. Pjesa më e madhe e kohës është për trajnimin e personelit, pra teknikisht instalimi mund të bëhet edhe brenda 2-3 ditësh për një pikë kufitare, por është trajnimi i personelit, që relativisht kërkon më shumë kohë.

Për sa i përket vlerës së investimit, ajo vlerë është përcaktuar për 8 pikat kufitare, jo vetëm për Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe parashikon rinovimin e infrastrukturës ekzistuese të sistemeve të Policisë së Shtetit, pra nuk do të jetë vetëm për një përfitim për sistemin PISCES dhe pastaj është instalimi fillon nga serverët deri në pikat fundore të pikave kufitare, si kompjuterët, skanerët për leximin e pasaportës dhe e gjithë pjesa tjetër.

Për pyetjen se kush do ta bëjë administrimin e të dhënave, administrator do të jetë Ministria e Brendshme, pra Policia e Shtetit. Në momentin që sistemi instalohet do të ketë një staf teknik në nivel administratori dhe vetëm me kërkesën tonë, pjesa e suportit (PISCES), do të ndërhyjë për të na ndihmuar apo për të bërë modifikime, në qoftë se do të na duhen në të ardhmen.

Ermonela Felaj - Ky sistem referon vetëm të dhënat e brendshme apo edhe ato të jashtme, për shembull sistemin e të dhënave që ka Interpoli.

Ernest Dimashi - Po, ndërvepron me Interpolin dhe me atë që quhet *terrorist screen list* të FBI-së. Pra, i ka të gjitha mundësitë, që të ndërveprojë me to. Çfarë kemi ne sot normalisht, do të jetë edhe në PISCES. Në të ardhmen mund të shtohen edhe ndërveprime të tjera.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Dimashi për përgjigjen!

Është edhe një pyetje tjetër.

Rovena Voda - Për pyetjen e dytë, unë do t'ia kaloj fjalën drejtorit të Migracionit në Departamentin e Kufirit dhe Migracionit pranë Policisë së Shtetit, zotit Kumria.

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zoti Kumria!

Ylli Kumria - Faleminderit për pyetjen!

Ndërkohë, me këtë protokoll të ripranimin, ne po përpiqemi të plotësojmë dekorin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së të firmosur në vitin 2005. Në marrëveshjen përkatëse stipulohet (në nenin 19), bërja e protokolleve 2-palëshe. Jemi drejt plotësimit të plotë të këtij detyrimi. Janë disa vende me të cilat ne nuk kemi problematika, si vendet baltike (Estoni, Letoni, Lituani) me të cilat nuk kemi probleme, por marrëveshja kuadër në vetvete, është e implementueshme. Ndërkohë, protokollin përcakton autoritetet kompetente

për implementimin e marrëveshjes dhe pikat e kalimit kufitar ku implementohet kjo marrëveshje. Kështu, ne po shkojmë drejt plotësimit të këtij dekori. Njëkohësisht, kemi në proces një protokoll ripranimi me Greqinë. Gjithsesi, me këtë vend marrëdhëniet në këtë fushë janë shumë të mira, pra për implementimin e marrëveshjes. Akoma është në axhendë protokoli i ripranimit me Greqinë.

Me këto protokolle ripranimi po plotësojmë marrëveshjen kuadër të firmosur në vitin 2005.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Kalojmë në diskutime. Nuk ka.

Kuptova që janë dy marrëveshje ndërkombëtare totalisht të favorshme. Kjo është edhe arsyeja pse nuk ka diskutime të tjera.

Ju faleminderit, për të gjitha përgjigjet që dhatë, sepse ato shkojnë përtej shpjegimeve që janë bërë në relacionet bashkëlidhur! Ato na ndihmojnë edhe ne si komision, por i shërbejnë edhe publikut për t'u informuar mbi atë që është duke bërë Ministria e Brendshme për ruajtjen e rendit dhe sigurisë.

Kalojmë në votimin e secilës prej marrëveshjeve.

Atëherë, kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”.

Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”. Edhe ky projektligj ka dy nene.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

Falënderoj për prezencën e tyre të ftuarit nga Ministria e Brendshme dhe nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme!

Të dyja marrëveshjet do të kalojnë në parlament ditën e hënë.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA